Sipas matjeve të realizuara rezulton se zyra nr. 342 ka sipërfaqe prej 35 m2, zyra nr. 344 ka sipërfaqe prej 35 m2, zyra nr. 345 ka sipërfaqe prej 45.8 m2 dhe zyra nr. 347 përfshin sipërfaqen prej 43.4 m2. Qiradhënia e këtyre zyrave është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë institucionale dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. Pasi që Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrdhënie kontraktuale të qirasë, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisojë më datë 20 dhjetor 2022 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e zyrave nr. 342, 344, 345 dhe 347. Kësisoj është përcaktuar edhe çmimi i qirasë për secilën zyre, ashtu që qmimi i qirasë për zyrën nr. 342 është € 394.00/muaj (€ 11.27/m2); për zyrën nr. 344 çmimi i qirasë është € 394.00/muaj (€ 11.27/m2); për zyrën nr. 345 çmimi i qirasë është € 516.00/muaj (€ 11.27/m2) dhe për zyrën nr. 347 çmimi i qirasë është € 473.00/muaj (€ 10.91/m2).Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/58

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, nenit 10.1.2 të Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 16.5 m^2 të parcelës 00339-5 ZK Podujevë në pronësi të NSh "KB Përparimi" PRN019, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 180.00 për një muaj për palën Kompania e Sigurimeve PRISIG.**
II. **Para lidhjes së marrëdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 6,480.00 për periudhën e shfrytëzimit të 3 viteve të fundit të parcelës në mënyrë të paautorizuar.**
III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë dhe Autoriteti i Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës Kompania e Sigurimeve PRISIG për qira direkte të asetit NSh "KB Përparimi" PRN019 për sipërfaqen prej 16.5 m2 në parcelën nr. P-71712062-00339-5 zona kadastrale Podujevë.
Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Parcela nr. 00339-5 shfrytëzimin aktual e ka si oborr 518 m2 dhe shtëpi-ndërtesë 380 m2, me sipërfaqe totale prej 898 m2 dhe në kuadër të parcelës gjinden të vendosura kioska dhe ndërtesë e tipit P+0 (kat përdhes) dhe kësisoj qiradhënia e këtij aseti është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë biznesore të kompanisë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. Pasi aktualisht Pala është shfrytëzues i pjesës prej 16.5 m2 (toka nën objektin P+0 të kompanisë Prisig), është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisojë më datë 15 dhjetor 2022 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e parcelës 00339-5 ZK Podujevë në sipërfaqe prej 16 m2, dhe në bazë të këtij raporti është përcaktuar çmimi në shumën € 180.00/ muaj. Kompania "Prisig" është duke e shfrytëzuar pjesën e parcelës 00339-5 ZK Podujevë dhe Autoriteti i Likuidimit nuk ka të dhëna se prej cilës kohë është duke e shfrytëzuar këtë parcelë, atëherë në në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën e 3 viteve të fundit dhe kësisoj Kompania "Prisig" do të jetë e obliguar që para nënshkrimit të kontratës së qirasë të paguajë retroaktivisht për periudhën e shfrytëzimit prej 3 vitesh në shumën totale prej 6,480.00 Euro (36x180.00/muaj). Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/59

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, nenit 10.1.2 të Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 9.5 m2 të parcelës 00339-5 ZK Podujevë në pronësi të NSh "KB Përparimi" PRN019, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 104.00 për një muaj për palën kompania "Fruta të Thata – Tetova 1963" përfaqësuar nga Neshat Rrahmani**

I. **Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 3,744.00 për periudhën e shfrytëzimit të 3 viteve të fundit të parcelës në mënyrë të paautorizuar.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë dhe Autoriteti i Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës kompania "Fruta të Thata – Tetova 1963" përfaqësuar nga Neshat Rrahmani pwr qira direkte për sipërfaqen prej 9.5 m2 në parcelën nr. P-71712062-00339-5 zona kadastrale Podujevë, pronë e PRN019 NSH "KB Përparimi" Podujevë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Parcela nr. 00339-5 shfrytëzimin aktual e ka si oborr 518 m2 dhe shtëpi-ndërtesë 380 m2, me sipërfaqe totale prej 898 m2 dhe në kuadër të parcelës gjinden të vendosura kioska dhe ndërtesë e tipit P+0 (kat përdhes) dhe kësisoj qiradhënia e kësaj pjese të asetit është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë biznesore të kompanisë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. Pasi që pala ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht i njëjti është shfrytëzues i pjesës prej 9.5 m2 (në të cilën ka të vendosur kiosken), është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisojë më datë 15 dhjetor 2022 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e parcelës 00339-5 ZK Podujevë në sipërfaqe prej 9.5 m2, dhe në bazë të këtij raporti është përcaktuar çmimi në shumën € 104.00/ muaj. Kompania "Fruta të Thata – Tetova 1963" është duke e shfrytëzuar pjesën e parcelës 00339-5 ZK Podujevë dhe Autoriteti i Likuidimit nuk ka të dhëna se prej cilës kohë është duke e shfrytëzuar këtë parcelë, atëherë në në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën e 3 viteve të fundit dhe kësisoj Kompania "Fruta të Thata – Tetova 1963" do të jetë e obliguar që para nënshkrimit të kontratës së qirasë të paguajë retroaktivisht për periudhën e shfrytëzimit prej 3 vitesh në shumën totale prej 3,744.00 Euro (36x104.00/muaj). Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022.

X _____

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/60

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, nenit 10.1.2 të Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe neneve 5.7 dhe 5.8 i Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 8 m2 të parcelës 00339-5 ZK Podujevë në pronësi të NSh "KB Përparimi" PRN019, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 87.00 për një muaj për palën kompania "Ylli Tobacco & Free Shop" përfaqësuar nga Arsim Topanica.

II. Para lidhjes së marrdhënies kontraktuale Qiramarrësi është i detyruar të paguajë borxhin në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, shumën prej € 3,132.00 për periudhën e shfrytëzimit të 3 viteve të fundit të parcelës në mënyrë të paautorizuar.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë dhe Autoriteti i Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës kompania "Ylli Tobacco & Free Shop" përfaqësuar nga Arsim Topanica për qira direkte për sipërfaqen prej 8 m2 në parcelën nr. P-71712062-00339-5 zona kadastrale Podujevë, pronë e PRN019 NSH "KB Përparimi" Podujevë.

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Parcela nr. 00339-5 shfrytëzimin aktual e ka si oborr 518 m2 dhe shtëpi-ndërtesë 380 m2, me sipërfaqe totale prej 898 m2 dhe në kuadër të parcelës gjinden të vendosura kioska dhe ndërtesë e tipit P+0 (kat përdhes) dhe kësisoj qiradhënia e këtij aseti është e arsyeshme pasi që do të lehtësonte ushtrimin e veprimtarisë biznesore të kompanisë dhe gjithashtu do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. Pasi që pala ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë dhe aktualisht i njëjti është shfrytëzues i pjesës prej 8 m2 (në të cilën ka të vendosur kiosken), është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisojë më datë 15 dhjetor 2022 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e parcelës 00339-5 ZK Podujevë në sipërfaqe prej 8 m2, dhe në bazë të këtij raporti është përcaktuar çmimi në shumën € 87.00/ muaj. Kompania "Ylli Tobacco & Free Shop" është duke e shfrytëzuar pjesën e parcelës 00339-5 ZK Podujevë dhe Autoriteti i Likuidimit nuk ka të dhëna se prej cilës kohë është duke e shfrytëzuar këtë parcelë, atëherë në në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, si periudhë të shfrytëzimit do të marrë periudhën e 3 viteve të fundit dhe kësisoj Kompania "Ylli Tobacco & Free Shop" do të jetë e obliguar që para nënshkrimit të kontratës së qirasë të paguajë retroaktivisht për periudhën e shfrytëzimit prej 3 vitesh në shumën totale prej 3,132.00 Euro (36x87.00/muaj). Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/61

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.1.3, neni 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 të Ligjit të AKP-në, nenit 10.1.3 të Rregullores me nr. 04/2022 e datës 31 gusht 2022 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe nenit 3.13.1 i Rregullores Nr. 4/2020 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për qiradhënie direkte të sipërfaqes prej 343 m2 të objektit sipas certifikatës së pronësisë me nr. 01790-2 zona kadastrale Gjakovë në pronësi të NSh "Deva" PEJ092, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 1,212.00 për një muaj për palën OJQ "Detyrimet Tona – Bamirësitë dhe Dinjiteti" përfaqësuar nga Bujar Muhaxhiri.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë dhe Autoriteti i Likuidimit për aprovimin e kërkesës së palës OJQ "Detyrimet Tona – Bamirësitë dhe Dinjiteti" përfaqësuar nga Bujar Muhaxhiri për qira direkte për sipërfaqen prej 343 m2 në parcelën nr. P-70705029-01790-2 zona kadastrale Gjakovë, pronë e PEJ092 NSH "Deva" Gjakovë

Sipas vlerësimit të AL-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me shfrytëzuesin do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore. Ngastra nr. 01790-2 zona kadastrale Gjakovë është objekt/zyre administrative e cila për momentin është e pa shfrytëzuar nga ndonjë palë. Kësisoj qiradhënia e këtij aseti është e arsyeshme pasi që do të ndikonte në mirëmbajtjen e asetit dhe rritjen e vlerës së tij. OJQ "Detyrimet Tona – Bamirësitë dhe Dinjiteti" ka për aktivitet primar bamirësinë dhe ofrimin e kushteve më të mira për organizimin dhe kryerjen e shërbimeve dhe aktiviteteve të ndryshme humanitare. Pasi që pala ka parashtruar kërkesë që të hyjë në marrëdhënie kontraktuale të qirasë, është formuar komisioni për vlerësimin e çmimit të tregut dhe kësisoj më datë 20 dhjetor 2022 është përgatitur Raporti i vlerësimit të çmimit të tregut të qirasë për qiradhënien e parcelës 01790-2 zona kadastrale Gjakovë në sipërfaqe prej 343 m2, dhe në bazë të këtij raporti është përcaktuar çmimi në shumën € 1,212.00/ muaj.

Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Agjencia Kosovare e Privatizimit
ZQ / HQ / QS - Pranohet
REPUBLIC OF KOSOVO
Privatisation Agency of Kosovo

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/62

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "KB Dobrusha" (në likuidim) PEJ031, nga Rajoni i Pejës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të NSh "KB Dobrusha" (në likuidim) PEJ031.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – Agencia Kosovare e Privatizimit – ZQ / HQ / QS – Prishtinë

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/63

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e e NSh Deva (në likuidim) PEJ092, nga Rajoni i Pejës.**

II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen e përkohshme të fondeve të Likuidimit të e NSh Deva (në likuidim) PEJ092, nga Rajoni i Pejës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/64

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Anulohet pjesërisht vendimi Nr. Ref. BD-164/26 i Bordit të Drejtorëve të datës 01.06.2022 për aprovimin e raportit të shpërndarjes së përkohshme të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Radusha" PEJ153, në raport me kreditorin me numër rendor 18 dhe 31 të paraqitur në listën për pagesë (Shtojcën 3) të Raportit të Shpërndarjes së Përkohshme të aprovuar më datë 01.06.2022.

II. Aprovohet Raporti Korrigjues i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit të PEJ153 NSh Radusha (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ekzistojnë fonde të mjaftueshme për aprovim të kërkesës për korrigjim të raportit të shpërndarjes të përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditoret e NSh "Radusha" PEJ153 (në likuidim) nga Rajoni i Pejes për përmbushjen e kërkesave të pranuara. Në raportin i cili korrigjohet, është lëshuar një gabim teknik sepse në shumën totale të aprovuar nga Bordi më datë 01.06.2022 me vendimin Nr. Ref. BD-164/26 ishte shuma gabim për arsye se tek njëri prej kreditorëve në listë, saktësisht tek kreditori me numër 18 dhe 31 në raportin e kaluar të shpërndarjes ishte bërë një lëshim teknik pasi që shuma për shpërndarje ishte e bazuar në shumën bruto në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, e cila në këtë vendim ishte kalkuluar gabim. Sipas kalkulimit në Raportin e Shpërndarjes të Aprovuar më datë 01.06.2022, kreditorit me numër rendor 18, i ishte paraqitur për pagesë shuma prej 297.53 €, ndërsa shuma e saktë për pagesë është 315.74 €. Ndërsa, tek po i njëjti kreditor, i vendosur me numër rendor 31, i ishte paraqitur për pagesë shuma prej 10,215.33 €, ndërsa shuma e saktë për pagesë është 10,840.29 €.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/65

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 Dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Anulohet pjesërisht vendimi Nr. Ref. BD-167/48 i Bordit të Drejtorëve të datës 28.07.2022 për aprovimin e raportit të shpërndarjes përfundimtare të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh "Ljuboten – Brick Factory" GJI158, në raport me kreditorin me numër rendor 9 të paraqitur në listën për pagesë (Shtojcën 3) të Raportit të Shpërndarjes së Përkohshme të aprovuar më datë 28.07.2022.**

II. **Aprovohet Raporti Korrigjues i Shpërndarjes së Përkohshme të fondeve të likuidimit të GJI158 NSH "Ljuboten – Brick Factory" (në likuidim) nga Rajoni i Gjilanit.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ekzistojnë fonde të mjaftueshme për aprovim të kërkesës për korrigjim të raportit të shpërndarjes të përkohshme të pjesshme të fondeve të likuidimit për kreditoret e NSh "Ljuboten – Brick Factory" GJI158 (në likuidim) nga Rajoni i Gjilani për përmbushjen e kërkesave të pranuara.

Në raportin i cili korrigjohet, është lëshuar një gabim teknik sepse në shumën totale të aprovuar nga Bordi më datë 28.07.2022 me vendimin Nr. Ref. BD-167/48 për arsye se tek njëri prej kreditorëve në listë, saktësisht tek kreditori me numër rendor 9 në raportin e kaluar të shpërndarjes ishte bërë një lëshim teknik pasi që në vendimin e Autoritetit të Likuidimit i janë pranuar 33 paga për pagesë, dhe pasi që ndarja është dashur të bëhet në dy kategori preferenciale, atë 40.1.6.1 (3 paga) dhe 40.1.7 (30 paga të papaguara), në Raportin e Shpërndarjes të aprovuar më datë 28.07.2022, ndarja është bërë saktë sa i përket kategorisë 40.1.6.1., mirëpo tek kategoria 40.1.7 i janë mbetur 33 paga për pagesë në vend të 30 pagave, sic do duhej të ishte. Në raportin e shpërndarjes përfundimtare, kreditorit me numër rendor 9 i ishte paraqitur për pagesë shuma prej 6,441.60 €, ndërsa në bazë të këtij raporti korrigjues të shpërndarjes përfundimtare, kreditorit me numër rendor 9 duhet të i paguhet shuma e saktë prej 5,856.00 €.
Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 Dhjetor 2022

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/66

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71611083-00504-3 me sipërfaqe prej 80 m² dhe P-71611083-00504-5 me sipërfaqe prej 283 m² ZK Treboviq dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant ka konstatuar që ngastrat kadastrale nr. 00504-3 dhe 00504-5 që janë objekt i kësaj kërkese shfrytëzohen si rrugë publike e asfaltuar brenda ZK Treboviq.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS – Agencia Kosovare e Privatizimit – ZQ / HQ / GS - Prishtinë - Priština – REPUBLIC OF KOSOVO – Privatisation Agency of Kosovo

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/67

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga aseti nr. P-71611071-04742-8 ZK Pejë me sipërfaqe prej 968 m² dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant ka konstatuar që ngastra kadastrale nr. 04742-8 që është objekt i kësaj kërkese shfrytëzohet si rrugë publike e asfaltuar në ZK Pejë.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/68

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71006021-00104-118 me sipërfaqe prej 6400 m² dhe P-71006021-00748-13 me sipërfaqe prej 843 m² ZK Jashanicë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant ka konstatuar që ngastrat kadastrale nr. 00104-118 dhe 00748-13 që janë objekt i kësaj kërkese shfrytëzohen si rrugë publike (një pjesë e shtruar me zhavor dhe një pjesë e asfaltuar) brenda ZK Jashanicë.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/69

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71006025-00314-7 me sipërfaqe prej 540 m²; P-71006025-00314-9 me sipërfaqe prej 702 m² dhe P-71006025-00314-11 me sipërfaqe prej 653 m² ZK Klinavc dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant ka konstatuar që ngastrat kadastrale nr. 00314-7; 00314-9 dhe 00314-11 që janë objekt i kësaj kërkese shfrytëzohen si rrugë publike të shtruar me zhavor brenda ZK Klinavc.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-174/70

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 18.3.1 të Shtojcës së të njëjtit ligj, nenit 42 të Ligjit nr. 03/154 për Pronësinë dhe të drejtat sendore, nenit 11 i Ligjit Nr. 2003/11 për Rrugët, nenit 3.10.4 të Rregullores nr. 04/2020 për Politikat dhe procedurat e likuidimit të NSH-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 23 dhjetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për heqje dorë nga asetet nr. P-71011034-00004-12 me sipërfaqe prej 1627 m² dhe P-71011034-00004-13 me sipërfaqe prej 998 m2 ZK Dugajevë dhe autorizohet Autoriteti i Likuidimit të paraqesë kërkesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për miratim përfundimtar për heqjen dorë nga aseti.**

II. **Pas aprovimit të kësaj kërkese nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ky aset të kalojë në pronësi të organit publik kompetent në territorin e së cilës ndodhet paluajtshmëria në përputhje me nenin 42 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.**

III. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant ka konstatuar që ngastrat kadastrale kadastrale nr. 00004-12 dhe 00004-13 dhe që janë objekt i kësaj kërkese shfrytëzohen si rrugë publike e asfaltuar në ZK Dugajevë.

Autoriteti i likuidimit arriti në përfundim se aseti nuk është fitimprurës dhe përveç kësaj në pajtim me nenin 11 të Ligjit Nr. 2003/11 "asnjë personi juridik ose fizik nuk i miratohet kërkesa për bartjen e pronësisë në rrugë publike ose ndaj një pjese të rrugës publike."

Për më tepër, heqja dorë nga ky aset nuk ndikon në të ardhurat e 20%, të ardhura të cilat u transferohen punëtorëve (BSPK) pas shitjes së aseteve gjatë likuidimit.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 23 dhjetor 2022.

Syzana Dautaj - Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës